



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 11-291  
Br. \_\_\_\_\_

Data 21.03.2023  
Datum \_\_\_\_\_

OBILIQ, OBILIC

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Më datë:21/03/2023

E lidhur në mes të:

Shoqatës humanitare "KIF Liria" nga qyteti Växjö, Suedi, nr. biznesi:802439-8375, dhe Komunës së Obiliqit, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe rritjes së efikasitetit në shkollat e Komunës së Obiliqit, Shoqata Liria dhe Komuna janë pajtuar më sa vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi të mirëkuptimit është bashkëpunimi i ndërsjellë në sjelljen e një donacioni në Kosovë nga Suedia, me banka shkollore, karriga tavolina, dhe pajisje të tjera kompletoese për shkollat e Komunes së Obiliqit. Vlera e përafërt e donacionit llogaritet të jetë rreth 80,000€.

Neni 2

Përgjegjësitë e Shoqatës

KIF Liria siguron donacionin nga shteti suedez dhe përcjellë të gjithë procesin, nga nisja e paisjeve shkollore, transportimit të tyre si dhe transferim në Komunen e Obiliqit. KIF Liria me të hollat e siguruar nga Komuna, do të mbuloj vetëm shpenzimet që dalin nga transporti. Në rast që mjetet teprojnë, ato do të vendosen në një fond për sjelljen e paisjeve dhe nuk mund të përdoren për arsye tjera.

### **Neni 3**

#### **Përgjegjësitë e Komunës**

Komuna në emër të participimit për sjelljenë e donacionit në Kosovë, paguan shumen prej 5,000€ për transport (*pagesa bëhet para pranimit të donacionit*). Komuna gjithashtu do të ndihmoj në përgatitjen e dokumentacionit dhe në komunikimin me autoritetet tjera shtetërore për të siguruar sjelljen me kohë të paisjeve shkollore.

### **Neni 4**

#### **Administrimi i punëve**

Të dy palët do të caktojnë personat kontaktues të cilët do të bashkërendojnë punët deri në pranim-dorëzimin e donacionit.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja**

Ky memorandum hynë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe ka kohëzgjatje prej 6 muajsh. Nëse sigurohet material, atëherë mjetet do të dërgohen në afat më të shkurtër.

### **Neni 6**

#### **Ndryshim – Plotesimi**

Çdo ndryshim i këtij memorandum mund të bëhet vetëm në pajtim të plotë nga të dy palët. Në rast kontesti, palët mosmarrëveshjet do ti zgjidhin me mirëkuptim.

---

Neni 7

Ky memorandum është bërë në katër kopje, nga dy për secilen palë.

Vëxjö 20230301

Për KIF Liria

  
KIF LIRIA  
Skogsnäsvägen 4 A, 352 37 Växjö  
Tel. +46(0)707775129

Xhafer Balaj

Për Komunen e Obiliqit

  


Xhafer Gashi